



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 461 Prot.

Tiranë, më datë 31.05.2024

**VENDIM**

**Nr. 139, datë 31.05.2024**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 31.05.2024:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Kompleks me objekt shërbimi 1-3 kate dhe vila banimi 1, 2 dhe 3 kat, me 1 kat nëntokë, me pishina, kabina elektrike dhe mur rrethues”, Njësia strukturore FA/47, në pasuritë nr. 147/40, nr. 147/59, nr. 147/60, nr. 147/63, nr. 147/66, nr. 147/71, nr. 147/74, nr. 165/55, nr. 165/58, Zona Kadastrale 3550 dhe në pasurinë nr. 28/62, Zona Kadastrale 1604 në pronë të ‘AS Sonstruction’ dhe pasurinë me nr. 147/43, Zona Kadastrale 3550 në pronësi të Artur Heta, Aleksandër Cena dhe Aleksandri Casili, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë, me zhvillues subjekti “**Rolling Hills By the Lake**”;
2. Gjatë procesit të zbatimit, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, datë 17.05.2018, neni 72, pika 1 dhe 2 dhe nëse ndeshen gjetje rastësore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së referuar nenit 145 - 147;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Sokol ISMAILI

